

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari **Jonuz Bugari**, në çështjen juridike të paditëses A. G. nga Ll., me banim të përhershëm në fshatin B., komuna e Rahovecit, kundër të paditurit J. R. M. nga fshati B., me banim në fshatin H. e M., komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson avokati Q. Q., sipas autorizimit në shkresat të lëndës, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e kontestit **960,00 Euro**, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës të shqyrtimit kryesor më, datë **02.07.2018**. merr këtë:

**A K T G J Y K I M  
NË BAZË TË PRANIMIT**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses A. G. me banim të përhershëm në fshati B., KK – Rahovec, me të cilën.,

**VËRTETOHET** se paditësja është pronare e paluajtshmërisë si parcel kadastrale nr.178-0, me kulturë pemishte, e klasit të 3-të, në sipërfaqe prej 731 m<sup>2</sup>, dhe nr. 177-1 me kulturë oborr, sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup>, dhe kullosë e klasit të 3-të, sipërfaqe prej 380 m<sup>2</sup>, së bashku me shtëpinë e rrënuar me sipërfaqe prej 120 m<sup>2</sup>, të gjitha në ZK-B., në bazë të mbajtjes me mirëbesim - parashkrimit fitues çka i padituri është i obliguar të pranoj këtë të drejtë dhe të lejojë që paditësja në elaboratin kadastral të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë pranë Komunës së Rahovecit të evidentohet si pronare ku si bazë juridike do të shërbej ky aktgjykim tërë këtë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**SHPENZIMET procedurale secila palë i bartë të vetat.**

**A r s y e t i m**

Paditësja A. G. në tërësi ka ngelur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, dhe i propozoj gjykatës që kërkesëpadia e saj të aprovohet në tërësi si me bazë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditurit avokati Q. Q., në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më 02.07.2018. nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses, nga se prestacionet nga kontrata janë përmbushur. Kështu që gjykata fare nuk është lëshuar në shqyrtimin e mëtejme dhe ka marrë aktgjykim me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 148 si dhe në dispozitën e nenit 73 të Ligjit mbi marrëdhëniet obligative.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

**GJYKATA THEMEKORE NË GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC më datë 02.07.2018.**

**G j y q t a r i  
Jonuz Bugari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit div. civil në Prishtinë.